

SHOQERIA "JON&AR" SH.P.K.
Rruga "Qemal Stafa", Pallati Nr.31, Kati pare dhe Kati i dyte
TIRANE-ALBANIA

V E N D I M
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
"JON&AR" SH.P.K.

Ortaku i vetem shoqerise "Jon&Ar"Sh.p.k. sot me daten 26 Dhjetor 2018, ka kerkuar te miratoje raportin e shteses te Kapitalit te shoqerise te hartuar nga eksperti kontabel I regjistruar ne vleren prej 30.814.859 leke",

K O N S T A T O I S E :

Z.Arjan Avllaj me cilisine e ortakut te vetem dhe te administratorit ne shoqerine "Jon&Ar"Sh.p.k. ka kerkuar te miratoje raportin e hartuar nga eksperti kontabel per shtesen e kapitalit ne vleren prej 30.814.859 leke nga transferimi I nje pjese autonome te veprimtarise.

Per asetet e trupezuara per te cilat eshte zbritur tvsh-ja ne blerje , te behen rregullimet per zbritshmerine e tvsh-se ne perputhje me kerkesat e ligjit nr.92/2014 dhe te Udhezimit nr.6/2015 per tvsh-ne ne RSH.

Ne shqyrtimin,analizimin e bere nga ortakut i shoqerise u shpreh per miratimin e raportit te shteses te kapitalit te hartuar nga eksperti kontabel I regjistruar nga transferimi I nje pjese autonome te veprimtarise pa pagese,sipas Statutit te Shoqerise dhe te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"ortaku,

V E N D O S I

- 1.Te miratoje Raportin e shteses te kapitalit te shoqerise te hartuar nga eksperti kontabel I regjistruara.
2. Miratimin e shteses te kapitalit ne Shumen prej 30.814.859 leke.
- 3.Kapitali I shoqerise pas shteses te kapitalit behet prej 110.054.486 leke(ishte 79.239.627 leke behet prej 110.054.486 leke), I perbere nga nje kuote dhe zoterohet nga ortakut I vetem Z.Arjan Avllaj.
- 4.Gjithe dokumentacioni i pregaditur per zmadhimin (shtesen) e kapitalit te shoqerise te depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit sipas kerkesave te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" I ndryshuar,dhe statutit te shoqerise. Vendimi u muar nga ortakut I vetem.

PER SHOQERINE "JON & AR" SH.P.K.



SHOQERIA "JON&AR" SH.P.K.

**Rruga "Qemal Stafa", Pallati Nr.31, Kati pare dhe Kati i dyte
TIRANE-ALBANIA**

**V E N D I M
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
"JON&AR" SH.P.K.**

Ortaku i vetem shoqerise "Jon&Ar"Sh.p.k. sot me daten 23 Dhjetor 2018, ka kerkuar te miratoje shtesen e Kapitalit te shoqerise per shkak te ndryshimeve ligjore, si dhe emerimin e ekspertit kontabel per hartimin e Raportit te Shteses te Kapitalit te shoqerise ne pepruthje me kerkesat ligjore e Standartet e Kontabilitet",

K O N S T A T O I S E :

Z.Arjan Avllaj me cilisine e ortakut te vetem dhe te administratorit ne shoqerine "Jon&Ar"Sh.p.k. ka kerkuar te analizoje te gjitha kerkesat ligjore dhe perfundimin e procedurave si pasoje e ndryshimeve ligjore.

Shoqeria "Jon&Ar"sh.p.k. u krijua si shoqeri re me kontribute ne natyre nga ortakut, dhe meqenese baza material, asetet e trupezuara qe duhen perdorur per ushtrimin e aktivitetit te klinikes mjekesore, ishin gjendje tek shoqeria "Ani"sh.p.k. dhe nga ndryshimet ligjore duhej ndare aktiviteti I klinikes mjekesore nga aktiviteti ne fushen e strukturave akomoduese. Konkretisht : Per shkak te ndryshimeve te reja ligjore eshte kerkuar qe Personat e tatueshem, qe aplikojne shkallen e reduktuar te TVSH-se, jane personat qe ushtrojne vetem veprimtari ekonomike ne fushen e strukturave akomoduese, sipas legjislacionit te fushes per turizmin. Nese personi i tatueshem ushtron edhe veprimtari te tjera, pervec asaj ne fushen e strukturave akomoduese, atehere duhet te jetë i regjistruar si person i tatueshem me vete, per qellime te veprimtarise ne fushen e strukturave akomoduese.(Shtuar me VKM 652 dt.10.11.2017). Per kete arsye, shoqeria "Ani"sh.p.k. ka transferuar te gjitha materialet kryesore e ndihmese dhe asetet qe perdoreshin per ushtrimin e veprimtarise te klinikes mjekesore tek shoqeria e re "Jon&AR". Ky transaksion eshte trajtuar si transferim te nje pjese autonome te veprimtarise pa pagese. Ne kete menyre shoqeria e re "Jon&Ar"sh.p.k. duke i perfitar keto materiale e asete pa pagese, atehere kjo bene te nevojshme dhe kalimin ne kapital te shoqerise, nepermjet shteses te kapitalit te shoqerise "Jon&Ar"sh.p.k.

Meqenese transferimi I veprimtarise ekonomike nuk perben furnizim malli ose sherbimi, ne kuptimin e ligjit nr, Nr,92/2014,date 24.07.2014 "Per TVSH-ne"neni 16, shoqeria "Ani" shpk per transferimin e veprimtarise ekonomike, ka hartuar dhe kontraten e transferimit.

Sipas te dhenave te paraqituar nga departamenti i finances rezulton qe ne zerin materiale jane perfshire te gjitha vlerat e materialeve qe perdoren per veprimtarine e klinikes mjeksore prej 1.040.423 leke dhe te kaluara tek shoqeria "Jon&Ar", ndersa vlere neto e asteve te trupezuara te klinikes mjekesore jane perfshire te gjitha ato asete qe perdoren dhe i sherbejne veprimtarise te klinikes mjekesore prej 29.774.436 leke.



Per materialet kryesore e ndihmese nga shoqeria "Ani"sh.p.k.ne deklarimet e bera ne librat e blerjes nuk eshte zbritur tvsh-ja, pra blerjet qe ishin te destinuar per furnizimin e perjashtuar jane trajtuar si blerje te perjeshtuara. Edhe per asetet eshte ndjekur e njejta procedure nga shoqeria "Ani" shpk lidhur me zbritshmerine e tvsh-se, por ne kater raste per asete te blera ne vitin 2015 te cilat nuk ishin te destinuar per kliniken mjekesore, " i eshte zbritur tvsh-ja, por me transaksionin e transferimit u vendos qe keto kater asete te kalojne tek shoqeria "Jon&Ar" , dhe per keto asete lind nevoja e rregullimit te tvsh-se se zbritshme ne blerje per shkak te transferimit te aktivitetit te pjesshem me nje destinacion si furnizime te perjashtuara.

Ne shqyrtimin, analizimin e bere nga ortaku i shoqerise u shpreh per dokumentacionin qe paraqiti drejtimi I shoqerise per shtesen e kapitalit nga vlera e materialeve e aseteve nga transferimi I pjesshem I aktivitetit pa pagese, sipas Statutit te Shoqerise dhe te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"ortaku,

V E N D O S I

1. Te zmadhohet kapitali I shoqerise nga vlera e materialeve dhe aseteve sipas dokumenatve kontabel te shoqerise sipas raportit te ekspertit kontabel.

2. Per hartimin e raportit te shteses te kapitalit te shoqerise me burim (kontribute ne natyre) emroj Znj.Leze Abazi, me licence nr.24, date 24.02.2000 eksperti kontabel e regjistruar.

3. Gjithe dokumentacioni i pregaditur per zmadhimin (shtesen) e kapitalit te shoqerise me burim (kontribute ne natyre), te depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit sipas kerkesave te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" I ndryshuar, dhe statutit te shoqerise.

Vendimi u muar nga ortaku i vetem.

PER SHOQERINE " JON & AR" SH.P.K.

ADMINISTRATORI

Arjan AVLLAJ

